

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E SUPERINTENDENTIT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301

PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.
SUPERINTENDENT

TELEFON (215) 400-4100
FAX (215) 400-4104

6 Gusht 2015

I dashur komunitet i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias:

Po ju shkruaj për të ndarë me ju disa informacione për rezultatet paraprake të testit të ri të PSSA, të kryer nga nxënësit e klasave të 3_ta deri në të 8_ta, të shkollave tona gjatë vitit të shkuar shkollor. Testet e reja të vitit 2015, ishin shumë të ndryshme prej testeve të vitit 2014. Testet e reja të vitit 2015, ishin të bazuara në Standardet Bazë të PA, të cilat përbëjnë njohuri dhe përmbajtje, të cilat janë pranuar nga Bordi Shtetëror i PA, si të nevojshme për nxënësit e Pensilvanisë, që të përgatiten për kolegji dhe karrierë.

Rezultati nuk ishte surprizë- duke vendosur standarde dhe njohuri më rigorozë- rezultatet paraprake, në PSSA e re, tregojnë se në të gjithë Pensilvaninë janë më pak nxënës që rezultojnë me vlerësimin I aftë ose I avancuar (proficient or advanced) në testet e Njohurive të Gjuhës Angleze dhe Matematikës. Performanca jonë në PSSA_në e re, pasqyron tendencën e të gjithë shtetit.

Duke i marrë në konsideratë këto rezultate, ne duhet të ngulitim në mendje disa pika të rëndësishme:

1. Rënia e performancës së nxënësve në nivelin e PSSA të re, **nuk do** të thotë që nxënësit janë duke mësuar më pak. Testet e reja janë bazuar në një përmbajtje të ndryshme dhe më të vështirë dhe nuk mund të krahasohen thjeshtë me rezultatet e testeve të vjetra (siç thuhet, nuk krahasohen mollët me dardhat). Ne e dimë që nxënësit dhe mësuesit janë duke punuar shumë; që ka shumë mënyra si mund të maten njohuritë dhe aftësitë e nxënësve; dhe se të gjithë nxënësit i kanë aftësitë që të rritin rezultatet shkollore
2. Ne e kemi të qartë që gjithë ky tranzicion cilësor do të kërkojë kohë dhe investim në trajnimin e mësuesve, materialeve shkollore, kujdestarinë e nxënësve dhe mbështetje të tjera. Ne akoma jemi në procesin e rregullimit të kurrikulës dhe të burimeve të tjera, në përputhje me këto standarde rigorozë të reja. Rezultatet e vitit të shkuar shkollor, janë një bazament i ri, që të ndërtojmë, ashtu siç edhe ne kërkojmë, që të gjithë nxënësit të kenë akses në këto mundësi dhe të jenë gati si për kolegji, ashtu edhe për punë.

3. Ne planifikojmë të rishikojmë dhe të bëjmë korigjimet e nevojshme në standardet e pranimi në shkollat e mesme – të cilat ndërkohë llogaritin një numër faktorësh dhe performacën sipas kohës- që të garantojë se kalimi në testin e ri të PSSA, nuk do të kufizojë aksesin e nxënësve në mundësitë e ofruara.
4. Ndërsa mund të ketë shqetësime për ndikimin e rezultateve të testit të PSSA në shkallën e performancës së mësuesve, mësuesit jo domosdoshmërisht do të shohin ndonjë ndikim. Matja e rritjes në sistemin shtetëror të vlerësimit e shikon rritjen e nxënësve në krahasim me atë të nxënësve në shkallë shteti dhe performanca jonë pasqyron tendencën e gjithë shtetit.

Duke e parë këtë situatë nga një pikë e ndritëshme, pavarësisht se testi ishte më i vështirë dhe i ndryshëm, gati 6,000 nxënës në klasat 3-8 në testin e Gjuhës Angleze, kaluan nga niveli më i ulët i performancës (poshtë bazik) në nivelin tjetër më të lartë (bazik).

Performanca jonë në provimin “Keystone” në vitin shkollor 2014-15 në Letërsi, gjithashtu është një shkak për t’u vlerësuar. (Provimet “Keystone” ishin gjithashtu në të njejtën linjë me Standardet Rigoroze të PA, kështu që është i vlefshëm krahasimi midis viteve.) Shkallëzimi i nxënësve në nivelin i aftë (proficiency) në Letërsi, për nxënësit që testoheshin për herë të parë tejkaloi me 7 përqind të pikëve, në krahasim me një vit më përpara dhe mbi tre të katërtat e shkollave tona të mesme e tejkaluan rezultatin e nivelit I aftë në Letërsi, në krahasim me një vit më parë.

Departamenti i Edukimit të Pensilvanisë (PDE) do të shpallë rezultatin tonë përfundimtar të PSSA dhe “Keystone” muajin e ardhshëm në vazhdim. Raportet individuale të nxënësve do të dërgohen nga PDE në shkollat diku nga mesi i muajit Shtator dhe do të kalojnë tek prindërit, ose kujdestarët në shtëpi. Ndërkohë, PDE ka përgatitur udhëzues të dobishëm për familjet, nxënësit dhe edukatorët rreth testeve të reja të PSSAs dhe rezultateve të tyre (e vlefshme në: <http://www.education.pa.gov/Pages/PSSA-Information.aspx#.VcOymhNViko>), të cilat do të përkthehen dhe do të postohen edhe në uebsajtin tonë.

Ne jemi përfshirë në Standardet Bazë të PA, sepse ato reflektojnë njohuritë dhe nevojat që kërkohen nga kolegji dhe jeta. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë fondet e nevojshme që të garantojmë përgatitjen e të gjithë nxënësve, në pritshmëritë aktuale, që kanë për ata kolegjet dhe punëdhënësit.

Ju faleminderit për mbështetjen e vazhdueshme të nxënësve dhe shkollave tona.

Sinqerisht,



William R. Hite, Jr., Ed.D.

Pesë Pika Kyçe që Duhet të njohin Prindërit Rreth PSSA_së të Re

1. Pranverën e kaluar në klasat e 3 deri 8, u zhvillua një test i ri i PSSA, në Njohuritë e Gjuhës Angleze dhe Matematikë. Ky vlerësim ishte i pari në PSSA, që ishte plotësisht në linjë me Standardet Bazë të PA, të cilat u adoptuan nga Bordi Shtetëror i Edukimit në Shtator 2013.
2. Rënia e nivelit të performancës nuk tregon se ai/ajo është duke mësuar më pak. Tranzicioni kërkon kohë, përfshirë zhvillimin e kurrikulës dhe burimeve mësimore, si edhe fakti që viti shkollor 2014-15, është viti i parë(viti një) për vlerësimet e reja. Nuk ka dobi krahasimi i drejtëpërdrejtë i rezultateve të testit të ri me ato të një viti më përpara, sepse ato janë bazuar në standarde të ndryshme. Rezultatet e vitit 2015, janë pikënisje dhe do të jenë bazë për rritjen e mëtejshme mësimore.
3. Proçesi i zhvillimit të standardeve të reja dhe shkallëzimit të rezultateve, janë duke u shqyrtuar me seriozitet maksimal e profesionalizëm të lartë nga një komitet i Edukatorëve të Pensilvanisë. Me familjarizimin e nxënësve dhe mësuesve me standardet e reja, si edhe me ridrejtimin e më tepër mjeteve drejt këtyre standardeve të reja, nxënësit do të përjetojnë një rritje mësimore të qëndrueshme.
4. Rezultatet e testeve të standardizuara nuk janë treguesi i vetëm i arritjeve të nxënësve. Nxënësit kanë aftësi dhe pika të forta të ndryshme. E rëndësishme është të vlerësohet nxënësi në mënyrë të plotë, duke përdorur një larmi matjesh të performancës.
5. Ju mund të ndihmoni fëmijën tuaj për të ecur përpara në arritjet shkollore duke i rishikuar bashkërisht rezultatet e tyre të PSSA_së dhe duke e nxitur atë të bëjë ç'ka është më e mirë në shkollë.

Kur të Merrni Rezultatet e Testit: Flisni me fëmijën tuaj

Pranverën e kaluar në klasat e 3 deri 8, u zhvillua një test i ri i PSSA, në Njohuritë e Gjuhës Angleze dhe Matematikë. Ky vlerësim ishte i pari në PSSA, që ishte plotësisht në linjë me Standardet Bazë të PA, të cilat u adoptuan nga Bordi Shtetëror i Edukimit në Shtator 2013.

Këto standarde të reja, kanë si qëllim të përgatitin më mirë nxënësit e Pensilvanisë për suksese, mbas përfundimit të shkollës së mesme, veçanërisht në përgatitjen për kolegji, ose në punë. Ka rëndësi t'ja theksojmë dhe shpjegojmë fëmijës tuaj, që tranzicioni në një standard të ri dhe më shumë rigoroz, kërkon kohën e duhur. Rezultatet e këtij viti nënkuptojnë ndërtimin e një baze për matjen e rritjes në të ardhmen dhe kjo rritje do të realizohet ndërsa ai/ajo do të familjarizohet më mirë me standardet e reja.

Rëndësi ka edhe ndihma juaj që fëmija të kuptojë se si ka dalë me rezultatet e vlerësimit – të dyja, anët e forta dhe mundësitë për përmirësim.

Më poshtë janë disa pika kryesore, që ju mund t'i theksoni me fëmijën tuaj në kohën që shqyrtoni rezultatet e testimit së bashku:

- Standardet e mësimi kanë ndryshuar. Ato janë më kërkuese dhe me pritshmëri më të lartë.
- Testet kanë ndryshuar. Pyetjet e testit janë në një linjë me këto standarde dhe shumë prej pyetjeve janë më komplekse se ato të viteve të shkuara.
- I kontrolloni së bashku pikët e testit. Kërkoni prej fëmijës tuaj se si ndihet ai/ajo ndaj testit dhe ku janë pyetjet e vështira për të.
- Në rast se rezultatet e testit nuk janë ato të pritëshme, e inkurajoni fëmijën tuaj. Mbani në vëmendje që testet e këtij viti ishin më të vështira dhe me kalimin e kohës, me punën dhe përpjekjet tuaja, ai/ajo do të bëhen të aftë të arrijnë pritshmëritë e reja.
- Ju dhe mësuesit mund t'a ndihmojnë fëmijën që ai të mendojë se çfarë duhet të bëjë që të jetë i suksesshëm në shkollë dhe më tutje. Mbani në vëmendje, që këto teste i ndihmojnë shkollat të përgatitin nxënësit për periudhën pas diplomimit të shkollës së mesme. Pavarësisht nga vitet që i duhen fëmijës të përfundojë shkollën e mesme, këto teste i ndihmojnë shkollat dhe mësuesit, që të sigurohen se ai/ajo është i gatshëm për të vazhduar drejtimin e mëtejshëm në jetë.
- Inkurajoni fëmijën që të vazhdojë të punojë shumë në shkollë dhe i bëni me dije mësuesit kur ai/ajo ka nevojë për ndihmë.